

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org: Org. Jedin: Org. Unit	0112
Nr. Prof. Br. Prof.	1203
Nr. i Takave Broj stavnica	4
Date:	25-05-22
PRISTINE/A NO.1	

Pranuar me: Primljeno:	25.05	20	22
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodata*	
1-352/02-	26769		

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije
Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare/ Nr.7/ 01.Mars 2019), dhe Nenin 13 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, lidhet kjo:

MARRËVESHJE

Në mes të

MINISTRISË SË EKONOMISË (ME)

përfaqësuar nga

AGJENCIA E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

dhe

KOMUNËS SË LIPJANIT

Për kalimin e pronësisë së Projektit dhe Raportit të Auditimit

“‘Progran I zbatimit të masave të EE Analiza financiare, Hartimi i raportit të auditimit të energjisë, dizajni teknik me specifikacion dhe mbikqyrja gjatë realizimit të projektit të ndriçimit public në nivel Lokal – Komuna për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë’”

PRISHTINË 2022

Ministria e Ekonomisë (në tekstin e mëtejme ME) e përfaqësuar nga përfaqësuar nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE) dhe Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejme: Përfituesi), janë pajtuar për bartjen e pronësisë së projektit dhe raportit të auditimit ““Progran I zbatimit të masave të EE Analiza financiare, Hartimi i raportit të auditimit të energjisë, dizajni teknik me specifikacion dhe mbikqyrja gjatë realizimit të projektit të ndriçimit public në nivel Lokal – Komuna për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë””si në vijim:

Neni 1 Objekti i marrëveshjes

1. ““Progran I zbatimit të masave të EE Analiza financiare, Hartimi i raportit të auditimit të energjisë, dizajni teknik me specifikacion dhe mbikqyrja gjatë realizimit të projektit të ndriçimit public në nivel Lokal – Komuna për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë”” për zbatimin të masave të eficiences së energjisë në Komunën e Lipjanit me Numër indentifikues: 210-20-7980-2-1-1 dhe numër të brendshëm : 213 20 027 211, I implementuar në vitin 2021 në Komunën e Lipjanit, në kuadër të auditimit të ndriçimit publik.
2. Vlera e financimit të auditimit të ndriçimit publik në Lipjanit – është 83,919.65 Euro.

Neni 2 Përgjegjësitë

1. Përfituesi merr në pronësi auditimin e energjisë nga Neni 1 i kësaj Marrëveshje.
2. ME, ka bërë auditimet e energjisë, dizajni dhe specifikacioni teknik, për të zbatuar masat për eficiencën e energjisë, duke financuar dhe përfunduar projektin nga Neni 1, e financuar dhe e cilësuar si pasuri kapitale e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. ME ruan të drejtën e shfrytëzimit të dhënave nga zbatimi i rekomandimeve të projektit nga Neni 1, pika 2 (në tekstin e mëtejme: Objekti i Marrëveshjes).

Neni 3 Menaxhimi dhe mbikqyrja e projektit

1. Përfituesi merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimesh projektin nga Objekti i Marrëveshjes (Secila pjesën e vet nga Neni 1, pika 2 e marrëveshjes).
2. Përfituesi mirëmban dhe bart të gjitha obligimet tjera që mund të dalin për funksionimin e rregullt të projektit nga Objekti i Marrëveshjes, si auditimi i ndriçimit publik në kuadër të projektit.
3. Përfituesi (pjesë shtesë të këtij dokumenti) do ta ketë në pronësi të gjithë dokumentacionin që bën të formalizuar projektin nga Objekti i Marrëveshjes.

- 3.1. Kontratat;
- 3.2. Faturat e projektit;
 - 3.2.1. Projektin detal;
 - 3.2.2. Projektin ideor;
 - 3.2.3. Urdhër blerja;
 - 3.2.4. Urdhër pagesa;
 - 3.2.5 Raportin e Auditimit;

Neni 4 Gjendja teknike e projektit

ME i dorëzon Përfituesit projektin nga neni 1 pika 2 të kësaj marrëveshje, në gjendje të rregullt teknike dhe sipas standardeve të paraqitura në projektin detal dhe sepecifikacionin teknik. Të gjitha këto duhet të jenë të vërtetuara nga menaxheri i kontrates.

Neni 5 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Ndonjë konflikt, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes, duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 6 Amandamentet


Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të Marrëveshjes.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje mbi bartjen e pronësisë do të filloi të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Në emër të:

AGJENCISË SË E KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË



Naim Zeqiri, U.D Drejtor Ekzekutiv i AKEE

Në emër të:

Komunes së Lipjanit



Imri Ahmeti, Kryetar



Prishtinë

Data e nënshkrimit: 25/07/2022